



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË GLLOGOCIT PËR VITIN 2021

Prishtinë, maj 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Glllogocit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Glllogocit (GLL), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Glllogocit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Glllogocit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Pagesa të ekzekutuara përmes vendimeve gjyqësore/përmbaremore ishin në vlerë prej 595,988€, prej tyre shpenzimet shitesë për procedura përmbaremore ishin në vlerë prej 148,176€;
- A2 Angazhimi i stafit për punë dhe detyra specifike pa procedura të prokurimit;
- A3 Mangësi në procedimin e pagesave, përkatësisht zotimi i mjeteve pas pranimit të faturave;
- A4 Mos pagesa e faturave brenda afatit ligjor;
- B1 Mos respektim i kriterëve gjatë vlerësimit të aplikacioneve të përfituesve të subvencioneve;
- B2 Mungesa e projektit ekzekutues në specifikat teknike të tenderit.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Glllogocit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Glllogocit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Glllogocit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Gllogocit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Gllogocit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësime të mundshme, rreth menaxhimit financiar dhe Kontrollit. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: mos pajtueshmëri me rregullat tek investimet kapitale, mallra dhe shërbime, subvencione dhe transfere dhe pagesa të ekzekutuara përmes vendimeve gjyqësore. Përveç këtyre kemi identifikuar çështje tjera në menaxhimin financiar dhe të pajtueshmërisë, përfshirë keq klasifikimin e shpenzimeve, të hyrat, menaxhimin e pasurisë dhe llogaritë e arkëtueshme. Po ashtu, procesi i raportimit në komunë është përcjellë me mangësi, kjo është vërejtur edhe me rastin e përgatitjes së PFV-të të cilat kishin edhe gabime tjera, të cilat janë vërejtur gjatë auditimit dhe janë bërë korrigjimet e mundshme.

Gjetjet dhe rekomandimet kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 13 rekomandime, prej tyre tetë (8) janë rekomandime të reja, katër (4) të përsëritura dhe një (1) pjesërisht e përsëritur.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Pagesat përmes vendimeve gjyqësore/përmbarrimore

Gjetja Neni 39 i LMFPP, përcakton ZKF-në e organizatës buxhetore përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallrat dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore. Ndërsa, sipas nenit 40, fatura mund të ekzekutohet direkt nga Thesari pas marrjes së urdhrin të prerë nga gjykata/përmbarruesi.

Shuma e pagesave direkte nga Thesari, në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbarrimore ishte 595,988€. Prej tyre 148,176€ ishin shpenzime të interesit dhe procedurave të gjykatës/përmbarrimit. Këto mjete janë shpenzuar nga:

- kategoria e pagave dhe mëditjeve në vlerë 499,027;
- investimet kapitale në vlerë 76,903€; dhe
- kategoria e mallrave dhe shërbimeve në vlerë 20,058€.

Sipas komunës, kjo ka ndodh si rezultat i obligimeve të dala nga kontrata kolektive për pagesën e shujtave dhe shpenzimeve të transport në sektorin e arsimit, pagesën e pagave jubilarë dhe vonesave në pagesën e faturave.

Ndikimi Pagesat e realizuara përmes vendimeve gjyqësore, vështirësojnë realizimin e buxhetit sipas planifikimeve respektivisht implementimin e projekteve, po ashtu krijojnë kosto shtesë në emër të shpenzimeve gjyqësore dhe interesit.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë planifikimin e drejtë të buxhetit duke forcuar disiplinën financiare që procesi i realizimit të pagesave të bëhet brenda planifikimeve buxhetore dhe afateve kohore të përcaktuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Angazhimi i stafit për punë dhe detyra specifike pa procedura të prokurimit

Gjetja Sipas Ligjit Nr. 06/L-0114 për zyrtarët, përkatësisht nenit 84, përcakton se “Marrëveshjet për shërbime të veçanta, sipas paragrafit 4 të nenit 12 të Ligjit të Shërbimit Civil nr. 03/L-149 të Republikës së Kosovës, të lidhura para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të vlefshme deri në afatin e përcaktuar në ato marrëveshje në pajtim me dispozitat e lartcekura. Pas kësaj periudhe, marrëveshjet për shërbimet e veçanta lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik.”

Komuna ka angazhuar gjashtë zyrtarë për punë dhe detyra specifike për të cilët nuk ka udhëhequr procedurat e prokurimit. Angazhimet e tyre janë realizuar me procedurë të thjeshtëzuar duke nënshkruar kontrata të cilat ju referoheshin ligjit të punës përkundër që të njëjtit ishin angazhuar në drejtorinë e kulturës si zyrtarë të stadiumit sintetik (shërbyes civil). Kohëzgjatja dhe angazhimi i zyrtarëve ishte për një periudhë prej 120 ditë.

Sipas zyrtarëve komunal angazhimi i stafit pa procedura ka ndodhur për shkak mungesës së njohurive për procedurat ligjore si dhe në mungesë të buxhetit nuk është lejuar plotësimi i pozitave me punëtorë të rregullt.

Ndikimi Lidhja e kontratave për punë dhe detyra specifike jo në pajtim me legjislacionin përkatës të prokurimit publik rritë rrezikun e angazhimit të stafit jo kompetent për pozita të caktuara dhe në mos arritjen e objektivave të caktuara.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë se janë ndjekur të gjitha procedurat dhe hapat e prokurimit në angazhimin e kontraktorëve individual për shërbime të veçanta. Po ashtu, menaxhmenti duhet të përkujdeset që angazhimet për pozitat e rregullta të zhvillohen përmes procesit të rregullt të rekrutimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Mangësi në procedimin e pagesave

Gjetja Rregulla financiare Nr.01/2013 përcakton që fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje, më pas zotimi i mjeteve, të procedohet urdhër-blerja, pastaj të pranohet malli apo shërbimi, dhe pas pranimin të faturës të ekzekutohet pagesa.

Në pesë⁴ raste, faturat në vlerë 162,133€ së bashku me situacionin mbështetës ishin pranuar nga komuna para datës së kërkesës për zotim të mjeteve dhe kërkesës për mallra dhe shërbime.

Shkak i kësaj ishte vendimi i thesarit për anulimin e disa pagesave të proceduara në fund të vitit 2020, si pasojë e mungesës së mjeteve si dhe mungesa e komunikimit në mes njësisë kërkuese, zyrtarit për pranimin e faturave dhe zyrtarëve të pranimin të punëve/mallrave.

Ndikimi Hyrja në obligime pa siguruar fondet e nevojshme paraprakisht, mund ndikoj në mos pagesën në kohë të obligimeve të cilat e rëndojnë buxhetin e vitit pasues. Njëkohësisht, mund të ketë padi përmes proceseve përmbarimore, të cilat rrjedhimisht kanë kosto shtesë.

Rekomandimi A3 Kryetari të sigurojë se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave në mënyrë që gjatë procedimit të pagesave, të bëhet fillimisht zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerje dhe në fund të pranohet malli/shërbimi dhe të kryhet pagesa.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Mos pagesa e faturave brenda afatit ligjor

Gjetja Sipas nenit 39.1 të Ligjit nr. 03 /L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, kërkohet që secila faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë të mallrave dhe shërbimeve të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas marrjes së faturës.

Në pesë⁵ raste, faturat në vlerë totale 216,945€ nuk ishin ekzekutuar

brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, vonesat kanë tejkaluar afatin deri 218 ditë kalendarike.

Shkak i mos pagesës me kohë të detyrimeve është planifikim jo i mirë i buxhetit dhe inicimi i proceduarve të shpenzimeve pa mjete në dispozicion.

Ndikimi

Detyrimet e bartura rrisin rrezikun në mos realizimin e projekteve dhe në mos arritjen objektivave të komunës. Si rezultat i nevojës për t'i paguar (obligimet) zotimet e viteve paraprake, njëherit kjo ndikon edhe në kosto shtesë në rast të padive nga furnitorët.

Rekomandimi A4

Kryetari duhet të sigurojë planifikim të buxhetit adekuat, si dhe inicimi i procedurave të shpenzimeve të realizohet vetëm kur mjetet janë në dispozicion me qëllim të kryerjes së gjitha detyrimeve ndaj operatorëve ekonomik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Mos respektim i kriterëve gjatë vlerësimit të aplikacioneve

Gjetja

Sipas thirrjes publike nr. 400/01-29622 të dt. 02.07.2020 për ofrimin e mbështetjes financiare për fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, ishte kërkuar kriteri për aplikim se "OJQ-ja aplikuese duhet të paraqesë dëshmi se gjatë një viti është marrë me organizimin e ngjarjeve kulturore, rinore ose sportive, si dhe nëse ka qenë përfituese e mjeteve financiare të ndara nga Komuna e Glllogocit, të njëjtat mjete i ka justifikuar duke paraqitur raportin financiar dhe narrativ ". Po ashtu, në thirrjen publike për aplikim, është kërkuar që të përgatitet projekti dhe formulari i buxhetit.

Nga testimi i mostrave, kemi identifikuar se në tre raste, Organizata Jo Qeveritare (OJQ) në fushën e sportit, kanë përfituar subvencione pa paraqitur dëshmi se gjatë një viti është marrë me organizimin e ngjarjeve kulturore, rinore ose sportive. Po ashtu, nuk kanë paraqitur dëshminë nëse kanë qenë përfitues të mjeteve financiare të ndara nga Komuna e Glllogocit dhe të njëjtat mjete i ka justifikuar duke paraqitur raportin financiar dhe narrativ. Përveç mungesës së dëshmimeve, OJQ-të kishin dorëzuar projektin dhe formularin e buxhetit të pa plotësuar/përgatitur, ku në projekt kishin paraqitur vetëm informatat e OJQ-së dhe në buxhet vetëm një shumë totale pa e ndarë në llojet e kostove.

Kjo ka ndodh si pasojë e vlerësimit jo të duhur sipas kriterëve të përcaktuara në thirrjen publike nga komisioni i vlerësimit.

Ndikimi

Përzgjedhja e përfituesve në kundërshtim me kriteret mund të dëmtoj kredibilitetin e procesit dhe mund të rezultojë që komuna të bashkëpunon me OJQ/individë të pa përshtatshëm. Kurse mos përgatitja e projektit dhe buxhetit, rritë rrezikun që OJQ të përdorin mjetet nga subvencioni jo për qëllimin e paraparë.

Rekomandimi B1

Kryetari, duhet të sigurojë se subvencionet ndahen në përputhje me kriteret e vendosura në thirrje publike dhe të siguroj se Organizatat jo qeveritare të mos përfitojnë subvencione pa i plotësuar/pagatitur projektin dhe formularin e buxhetit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B2 - Mungesa e projekteve ekzekutuese**

Gjetja Neni 20 pika 10 i Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (UOPP) kërkon që "Specifikat teknike për kontratën e punës, duhet të përfshijnë një projekt ekzekutues si pjesë substanciale të veten". Ndërsa pika 13 "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet ti bashkëngjitet specifikave teknike të cilat janë pjesë e dosjes së tenderit". Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.

Në tre raste për kontratat: Rregullimi i infrastrukturës trotuar dhe ndriçim publik në Komunën e Glllogocit (197,788€), Rehabilitimi dhe rikonstruimi i rrjetit të kanalizimit në Komunën e Glllogocit (144,750€) dhe Asfaltimi i rrugës në fshatrat Gllanasellë-Godancë (124,452€), komuna nuk kishte hartuar projekte ekzekutuese, por kishte iniciuar procedurat e prokurimit duke përgatitur vetëm paramasën dhe parallogarinë.

Shkaku i mungesës së projekteve ekzekutuese sipas zyrtarëve të komunës ishte mungesa e buxhetit për kontraktimin e një OE për hartimin e projekteve ekzekutive.

Ndikimi Mungesa e projekteve ekzekutuese dhe inicimi i procedurave për projekte kapitale vetëm me paramasë dhe parallogari, rritë rrezikun që gjatë procesit të ekzekutimit të projekteve të paraqiten pengesa të ndryshme si në aspektin profesional, ashtu edhe në vonesat e punimeve apo edhe në rritjen e kostove të projekteve.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë se për të gjitha aktivitetet e prokurimit që kanë të bëjnë me punë, të mos iniciohen procedurat pa u siguruar specifika të qarta sipas projektit ekzekutues të cilat do të ndikonin në eliminimin e vonesave dhe të kostove shtesë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Kontrollat e brendshme në raportimin financiar

Në vijim janë çështjet që kanë të bëjnë me prezantimin e të dhënave dhe përgatitjen në Pasqyra Financiare.

Çështja A5 - Klasifikim jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja

Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF “Mbi shpenzimin e parasë publike” shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime në kategoritë ekonomike jo adekuate në vlerë prej 13,243€, si në vijim:

Nga kategoria për mallrat dhe shërbimet janë planifikuar dhe realizuar pagesa në vlerë 5,000€, të cilat për nga natyra i takojnë kategorisë për subvencione dhe transfere; dhe

Nga kategoria për investime kapitale janë planifikuar dhe realizuar pagesa në vlerë 8,243€ të cilat për nga natyra i takojnë kategorisë së mallrave dhe shërbimeve.

Keqklasifikimi ka ndodh për shkak të planifikimit jo adekuat të shpenzimeve sipas kodeve ekonomike.

Ndikimi

Klasifikimet ekonomike jo të sakta, prezantojnë pamje jo të drejtë të shpenzimeve në PFV, duke mbivlerësuar/nënvlerësuar kategorinë ekonomike të shpenzimit, dhe nuk pasqyrojnë drejtë informacionet për kategoritë përkatëse të shpenzimeve.

Rekomandimi A5

Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet/kategoritë adekuate të buxhetit (apo të ridestinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme), dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet në mënyrë të drejtë dhe të saktë sipas kodeve ekonomike adekuate.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A6 - Mungesa e kontrolleve në përgatitjen e Draft Pasqyrave Financiare Vjetore

Gjetja

Përgatitja e PFV-e duhet të bazohet sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik dhe Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme si dhe sipas Rregullores së MFTP nr.01/2017 për Raportimin Vjetor Financiar të Organizatës buxhetore.

Komuna ka përgatitur dhe dërguar në Thesar PFV-të sipas afatit të paraparë deri me 30 janar. Megjithatë me rastin e rishikimit të PFV-e, nga ana e auditimit, janë vërejt disa çështje të cilat i kemi rekomanduar

Komunës për korigjim.
Çështjet e identifikuar janë:

Pasqyra 1, neni 13 - Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, Burimi i Fondeve -Pranimet, nuk është prezantuar Kthimi i Depozitave në vlerë 76,170€. Pastaj kjo nuk është prezantuar edhe të Shfrytëzimi i Fondeve -Pagesat, të shënimi 7 pagesat tjera si Kthimi i depozitave.

Pasqyra 1, neni 13 - Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme të burimi i fondeve- grantet e përcaktuara të donatorëve është prezantuar vlera për 11,000€, ndërsa shpenzimi i donacionit ishte në vlerë 531,620€.

Pasqyra 2, neni 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit pjesa hyrja e paras në LLVTH shënimi Nr. 8 të hyrat tatimore buxheti final është prezantuar me vlerë 716,000€ ndërsa sipas Buxhetit është 495,700€.

Pasqyra 2, neni 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit pjesa hyrja e paras në LLVTH shënimi nr. 9 të hyrat Jo tatimore buxheti final është prezantuar me vlerën 451,000€, sipas Buxhetit është 810,951€.

Pasqyra 2, neni 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit të Hyrja e Paras tek të tjera, nuk është prezantuar Pranimi i Depozitave në vlerë 185,629€.

Pasqyra 2, të Hyrja e parasë së gatshme shënimi Nr. 11 grantet e përcaktuara të donatorëve realizimi për vitin 2021 të hyrat nga donacionet janë në vlerë prej 528,437, ndërsa në pasqyra është prezantuar në vlerë 11,000€.

Me rekomandim të auditorëve , PFV janë korigjuar në afatin e paraparë.

Kjo kishte ndodh për shkak të kontrolleve të brendshme jo të mjaftueshme dhe kujdesit të mangët të stafit përgjegjës në përgatitjen e PFV-ve.

Ndikimi

Paraqitja jo e drejtë dhe e saktë e të dhënave në PVF, jep një pasqyrim jo të plotë për shfrytëzuesit e PFV-ve. Si pasojë, kjo mund të ndikojë edhe në marrjen e vendimeve të gabuara nga vetë Komuna apo palët tjera të interesit.

Rekomandimi A6

Kryetari duhet të sigurojë që përmes personave përgjegjës, gjatë hartimit të pasqyrave për vitin 2022, ti kushtohet vëmendje që mos të kenë gabime kontabël dhe administrative dhe të gjithë zërat në pasqyrat financiare të jenë drejtë dhe të sakta.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Të hyrat

Të hyrat vetanake të realizuara në 2021 ishin në vlerë 1,167,354€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja, participimet etj. Përveç të hyrave vetanake, komuna ka pranuar edhe të hyra indirekte të cilat grumbullohen nga niveli qendror në vlerë prej 631,178€ (gjobat në trafik 602,338€ dhe të hyrat nga gjykata në vlerë prej 28,840€).

Çështja A7 - Mangësi në menaxhimin e të dhënave nga tatimi në pronë

Gjetja Neni 11 paragrafi 1 i Ligjit me nr. 06/L-005 për Tatimin në pronën e paluajtshme - Zbritja për vendbanimin parësor, paraqet: “Personi fizik, i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit para vitit tatimor se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor dhe e deklaron këtë në Komunë apo gjatë fazës së inspektimit, i lejohet zbritja prej pesëmbëdhjetë mijë (15,000€) nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit”.

Nga analiza e bazës së shënimeve të Protax-it kemi konstatuar se në 84 raste (prona/objekte të tatim-paguesve), ju ishte bërë zbritja e parregullt e vendbanimit parësor prej 15,000€, si rezultat, për arsye të nën-faturimit të hyrat janë më të vogla për 1,890€.

Po ashtu, nga analiza e bazës së shënimeve Protax, si rezultat i mos zbritjes së vendbanimit parësor prej 15,000€, Komuna ka mbi-faturuar 52 tatimpagues në vlerë prej 1,170€.

Për rastin e parë shkaku është si rezultat i mos deklarimit të vendbanimit parësor nga ana e tatimpaguesve dhe mos vlerësimit (ri anketimit) gjatë fazës së inspektimit nga ana e anketuesve në teren. Derisa për rastin e mbi faturimit, shkaku është tek mungesa e kontrollit dhe vëmendjes në përditësimin e të dhënave të tatim paguesve.

Ndikimi Dobësitë e identifikuar lidhur me menaxhimin e të dhënave të tatimit në pronë, respektivisht mos përditësimi i informatave të tatimpaguesve, ndikon në nënvlerësimin/mbivlerësimin e bazës tatimore, me çka krijohen paqartësi dhe jo siguri në bazën e të dhënave për tatimpaguesit.

Rekomandimi A7 Kryetari duhet të sigurojë kontrolle shtesë në departamentin e tatimit në pronë, në mënyrë që të dhënat në sistemin Protax të jenë të harmonizuara me rregulloren e tatimit në pronën e paluajtshme të komunës dhe me ligjin e tatimit në pronë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Vonesa në deponimin e parasë së gatshme në llogarinë bankare

Gjetja Neni 11 i Rregullës Financiare 03/2010 për të hyrat përcakton që paratë e grumbulluara nga Organizatat Buxhetore (OB) nga arkëtimet për shërbime në lartësi deri 10€, duhet në fund të ditës të depozitohen në llogarinë bankare.

Në dy raste kemi evidentuar se paratë e arkëtuara për shërbime kadastrale dhe në administratë, nuk ishin depozituar me kohë në arkë, rrjedhimisht në

bankë. Vonesat ishin nga dy ditë deri katër ditë, ndonëse vlerat monetare nuk ishin materiale. Përkatësisht:

Të hyrat e arkëtuara nga taksat për ndërrimin e destinimit të tokës nga data 24.02.2021-26.02.2021 në vlerë 480.50€ ishin deponuar në bankë me datë 26.02.2021.

Të hyrat e arkëtuara nga taksat për regjistrim të automjeteve nga data 08.07.2021-09.07.2021 në vlerë 876€ ishin deponuar në bankë me datë 12.07.2021.

Kjo ka ndodhur si shkak i kontrolleve të brendshme jo efektive përkatësisht rrethanave vështirësuese në organizimin e stafit.

Ndikimi

Mos deponimi me kohë i mjeteve në llogarinë bankare, mund të rritë rrezikun e humbjes apo edhe keq përdorimit të parasë së gatshme.

Rekomandimi C1

Kryetari të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në mënyrë që paratë e gatshme të grumbulluar të dorëzohen me kohë në arkë dhe të depozitohen në bankë në harmoni me kërkesat e rregullës financiare për të hyrat.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 5,448,270€, prej tyre ishin shpenzuar 4,512,873€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me ndërtim dhe rregullim të infrastrukturës rrugore, ujësjellësit dhe kanalizimeve, ndërtim të shkollave dhe parqeve, shpronësime, blerje të pajisje dhe përmirësime të ndryshme të kapitalit.

Çështja A8 - Vonesa në përfundimin e punëve të kontraktuara

Gjetja Rregulla dhe Udhëzuesi Operativ të Prokurimit Publik, pikat 61.6, 61.19 dhe 61.20 përcaktojnë se: “Menaxherët e kontratës janë përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe duhet të sigurojnë se OE kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë. Secila kontratë publike ka të përcaktuar afatin kohor të implementimit.

Në tre pagesa të testuara, kemi evidentuar vonesa deri në 41 ditë .Vonesat kanë të bëjnë me projektet si në vijim:

- Kontrata “Ngjyrosja dhe suvatimi i objekteve shkollore faza II” në vlerë 15,310) e nënshkruar me datë 01.10.2021;
- Kontrata “Ndërtimi i infrastrukturës Nekoc, Kizhnarekë” në vlerë 81,341€ e nënshkruar me datë 07.07.2021; dhe
- Kontrata “Infrastruktura në Komoran I,II,II dhe IV, projekt dy vjeçar” në vlerë 143,614€ e nënshkruar me datë 22.10.2020.

Duhet theksuar se në asnjërin prej këtyre rasteve nuk kishte kërkesë/aprovim për zgjatjen e afatit për realizimin e kontratave.

Sipas zyrtarëve komunal, shkak i vonesave në pune ishte pandemia COVID-19, megjithatë, vonesat janë reflektuar edhe nga mungesa e kontrolleve të brendshme.

Ndikimi Vonesat në kryerjen e projekteve ndikojnë në rritjen e obligimeve kontraktuese të cilat mund të kenë implikime buxhetore për buxhetin e vitit pasues. Kjo, po ashtu, ndikon në performancën dhe mos arritjen e objektivave të përcaktuara të Komunës.

Rekomandimi A8 Kryetari duhet të siguroj që, përmes menaxherit të prokurimit, si dhe menaxherëve të kontratave, se realizimi i kontratave bëhet në përputhje me planin dinamik/afatin për kryerjen e punëve/furnizimeve dhe për vonesat e pa arsyeuara, të aplikohen masat e parapara në kontratë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.4 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 514,542,743€, pasurive jokapitale është 719,394€, si dhe e stoqeve 3,976€.

Çështja B3 - Dobësi në menaxhimin e pasurisë

Gjetja Neni 6.3 i Rregullores nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare thotë se: Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria. Më tutje Neni 19.4.3 i Rregullores nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare: Përcakton se çdo fund vit duhet të bëhet krahasimi i gjendjes se inventarizuar me gjendjen e regjistrave të pasurive jo financiare.

Nga testimet e realizuara, kemi evidentuar se në një rast, pagesa e shpenzimeve kapitale për hartimin e projekteve zbatuese në vlerë 2,648€, nuk ishte regjistruar në SIMFK.

Ndërsa në katër raste, te cilat kanë të bëjnë me furnizim të pajisjeve, në vlerë 13,706€, nuk ishin regjistruar në sistemin e-pasuria.

Procesi i inventarizimit të pasurive jo financiare ishte kryer me vonesë, ku nuk ishte bërë krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare para datës së përgatitjes së PFV-ve. Si rezultat, nuk dihet diferenca mes gjendjes së regjistrit të përgjithshëm dhe inventarizimit.

Sipas zyrtarëve komunal, kjo gjendje ishte mungesa e një sistemi të komunikimit ndërmjet departamenteve, gjithashtu për shkak të njohurive lidhur me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurive.

Ndikimi Mungesa e regjistrave të saktë dhe të plotë shkakton mungesë të informatave për menaxhmentin lidhur me pasurinë që posedon komuna, shkakton mbi/nënvlerësim të pasurive si dhe mund të rezultojë në prezantimin jo të drejtë të informatave në pasqyra financiare. Ndërsa, mos krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurive dhe mos vlerësimi i pasurive, pamundëson marrjen e sigurisë lidhur me saktësinë dhe plotësinë e regjistrave të pasurisë.

Rekomandimi B3 Kryetari, duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale. Po ashtu duhet siguruar se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, si dhe më pas, të bëhet krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen kontabël të pasurive, duke i sqaruar të gjitha diferencat.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.5 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV e vitit 2021 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 3,330,640€. Pjesa më e madhe i takon tatimit në pronë në vlerë 1,675,994€ apo rreth 50%, licencat e biznesit në vlerë 1,263,078€ apo rreth 38%, qiraja në vlerë 366,308€ apo rreth 11% dhe leje ndërtimi në vlerë 25,260€.

Çështja B4 - Dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme

Gjetja

Sipas nenit 16 të Rregullore MF- nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar, Organizatat buxhetore që mbledhin të hyra janë të detyruara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumave të faturuara e të pa arkëtuara.

Arkëtimi i të hyrave duhet të bëhet sipas afateve kohore të përcaktuara në faturë për secilin lloj të të hyrave.

Komuna nuk kishte menaxhim efektiv në mbledhjen e të arkëtueshmeve pasi që vazhdon rritja nëpër vite tek tatimi në pronë dhe tek qiraja nga objektet publike. Në krahasim me vitin paraprak rritja ishte rreth 29,199€.

Për licencat e biznesit sistemi të cilin e përdor komuna nuk gjeneron një regjistër të arkëtueshmeve në detaje për bizneset individuale vetëm si vlerë të përgjithshme (faturimet - pranimet). Po ashtu për arkëtimin e tyre komuna nuk ka ndërmarr asnjë veprim.

Dobësitë e identifikuara lidhur me llogaritë e arkëtueshme janë për shkak të kontrolleve të brendshme jo efikase në menaxhimin përkatësisht arkëtimin e tyre, si dhe mos gjenerimi i regjistrit të arkëtueshmeve në detaje për licencat e biznesit ka ndodhur shkak i mosfunksionimit të modulit të obligimeve në sistem.

Ndikimi

Mos arkëtimi në kohë i të hyrave të ngarkuara ndikon në nivelin e fondeve të mbledhura për buxhetin komunal dhe reflekton negativisht në financimin dhe realizimin e projekteve nga të hyrat vetanake. Ndërsa mungesa e regjistrit të arkëtueshmeve në detaje mund të ndikoj në informata jo të plota për licencat e biznesit.

Rekomandimi B4

Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme në mënyrë të rritjes së efikasitetit në arkëtimin e tyre, duke mos përjashtuar edhe masat juridike. Po ashtu të siguroj funksionimin e sistemit për licencat e biznesit që të gjeneroj raporte sipas informatave të nevojshme për komunën.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁷	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Burimet e fondeve	15,399,334	17,235,875	15,432,138	15,583,238	14,633,794
Grante Qeveritare - Buxheti	14,092,674	14,179,276	13,060,000	13,832,852	13,065,169
Financimi përmes huamarrjes	0	80,608	71,560	116,583	37,905
Të bartura nga viti i kaluar	0	1,135,437	842,370	571,822	569,330
Të hyrat vetanake	1,306,660	1,306,660	926,588	716,372	732,610
Donacionet vendore	0	13,221	11,008	20,351	22,691
Donacionet e jashtme	0	520,673	520,613	325,257	206,090

Buxheti final ishte më i lartë se buxheti fillestar për 1,836,541€. Kjo rritje është rezultat i pranimit të buxhetit nga donacionet, të hyrave të bartura nga viti paraprak, financimi nga huamarrja dhe rimëkëmbja. Në vitin 2021 komuna ka shpenzuar 90% të buxhetit final, me një rritje prej 1% në krahasim me vitin 2020. Zbatimi i buxhetit mbetet në një nivel të kënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	15,399,334	17,235,875	15,432,138	15,583,238	14,633,794
Pagat dhe mëditjet	8,700,000	8,921,989	8,914,997	8,524,870	8,150,885
Mallrat dhe shërbimet	1,988,380	2,028,312	1,411,089	1,361,893	1,506,215
Komunalitë	232,508	269,574	213,075	194,766	187,252
Subvencionet dhe transferet	370,000	457,730	380,103	430,331	245,479
Investimet Kapitale	3,998,446	5,448,270	4,512,873	5,071,378	4,543,963
Rezervat	110,000	110,000	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 221,989€ si rezultat i financimit nga huamarrjet.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 39,932€ si rezultat i të hyrave të bartura nga viti i kaluar 36,120€, i financimit nga huamarrja 40,872 dhe një zvogëlimi prej 37,060 si rezultat i vendimit të Kuvendit Komunal nga i cili nga mallra dhe shërbime janë transferuar në shpenzime komunale.
- Buxheti final për shërbimet komunale ishte rritur për 37,066€ si rezultat i transferimit nga mallrat dhe shërbime në shpenzime komunale me vendim të Kuvendit Komunal.
- Buxheti final për subvencione dhe transfere në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 87,730€, si rezultat i vendimit të qeverisë në shumë 68,000€, të hyrave të bartura nga viti i kaluar 18,370€ dhe financimit nga huamarrjet 1,360€.
- Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,449,824€ si rezultat i të hyrave të batuara nga viti i kaluar në shumë prej 1,080,964€, granateve të përcaktuara të donatorëve 532,520€ dhe financimi nga huamarrja 6,580€ dhe një zvogëlimi prej 170,240 si rezultat i të hyrave të planifikuara dhe të pa realizuara.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat e realizuara nga Komuna e Gillogocit në 2021 ishin në vlerë 1,167,354€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja, participimet etj. Përveç këtyre të hyrave komuna ka pranuar edhe të hyra indirekte të cilat grumbullohen nga niveli qendror në vlerë prej 631,178€ (gjobat në trafik 602,338€ dhe të hyrat nga gjykata në vlerë prej 28,840€).

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
Totali i të hyrave	1,306,660	1,306,660	1,167,354	885,917	1,110,521
Të hyrat tatimore	495,709	495,709	716,423	452,717	511,163
Të hyrat jo tatimore	810,951	810,951	450,932	432,268	597,358
Të hyrat tjera	0	0		932	2,000

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020 ka rezultuar me 10 rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, katër (4) rekomandime janë zbatuar; katër (4) nuk janë adresuar ende, një (1) rekomandim është adresuar pjesërisht dhe një (1) rekomandim i mbyllur, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën e rekomandimeve nr. 4.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Të hyrat	Kryetari të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në mënyrë që paratë e gatshme të grumbulluar të dorëzohen me kohë në arkë dhe të depozitohen në bankë në harmoni me kërkesat e rregullës financiare për të hyrat.	Për vitin 2021 ka bërë përmirësime në deponimin e mjeteve me përjashtim paratë e grumbulluara nga qendrat nëpër fshatra.	Pjesërisht i zbatuar
2.	Të hyrat	Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të organizmit të veprimtarive inspektuese sipas kritereve ligjore të përcaktuara në mënyrë që shënimet rreth tatimit në pronë të janë të plota.	Komuna për vitin 2021 ka inspektuar 21% prona të paluajtshme	I zbatuar
3.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në procesin e vlerësimit dhe përzgjedhjes së tenderëve konform kritereve të përcaktuara në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë.	Janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	I zbatuar

4.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari, duhet t'i forcojë kontrollet mbi menaxhimin e subvencioneve dhe të siguroj që, fillimisht, kriteret e vendosura në thirrjet publike hartohen konform kërkesave dhe udhëzuesve të nivelit qendror dhe atij lokal që rregullojnë këtë fushë. Pastaj, të siguroj se subvencionet ndahen në përputhje me kriteret e vendosura në thirrje publike.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimimi
5.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se për të gjitha aktivitetet e prokurimit që kanë të bëjnë me punë, të mos iniciohen procedurat pa u siguruar specifika të qarta sipas projektit ekzekutues të cilat do të ndikonin në eliminimin e vonësve dhe të kostove shtesë.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimimi
6.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se çdo ndryshim në kushtet e kontratës para ose gjatë periudhës së zbatimit do të bëhet vetëm pas njoftimit të zyrës së prokurimit dhe marrjes së aprovimit nga zyra e prokurimit dhe ZKA.	Janë ndërmarrë veprimet e nevojshme..	I zbatuar
7.	Pasuritë	Kryetari, duhet të sigurohet që do të bëhet azhurnimi i regjistrimit të pasurive kapitale konform gjetjeve të auditimit të trajtuara me lartë për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale. Po ashtu duhet siguruar se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, si dhe më pas, të bëhet krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen kontabël të pasurive, duke i sqaruar të gjitha diferencat.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme..	Nuk ka filluar zbatimimi
8.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme në mënyrë të rritjes së efikasitetit në arkëtimin me kohë të llogarive të arkëtueshme.	Ka rritje të llogarive të arkëtueshme për tatimin në pronë dhe qirat, si dhe nuk janë ndërmarrë veprime për arkëtimin e taksave për biznes.	Nuk ka filluar zbatimimi
9.	Detyrimet Kontigjente	Rekomandimi A6-Kryetari duhet të sigurohet se zyra ligjore dhe e financave bashkëveprojnë në mënyrë sistematike për të siguruar shpallje të plota dhe të sakta të detyrimeve kontigjente.	Janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	I zbatuar

10.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari, duhet të sigurojë se për pozitat e kërkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë dhe se NJAB të plotësohet me staf të mjaftueshëm sipas rregullores për themelimin e NjAB.	Edhe pse ka qenë rekomandim i vitit paraprak NJAB ka arrit të mbulojë të gjitha fushat me rrezik të lartë dhe njëherit kjo njësi nuk e parasheh të nevojshëm shtimin e stafit.	Nuk është i aplikueshëm më
-----	----------------------	--	--	----------------------------

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme




Zukë Zuka, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Shehrije Shala, Drejtore e Auditimit



Fanol Hodolli, Udhëheqës i ekipit



Arian Zenelaj, Anëtar i ekipit



Sabile Muli, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



01 Nr 070/03-24012 dt. 30.05 2022

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Glllogocit, për vitin 2021 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Ramiz Lladrovci,

Kryetar i Komunës,

Data: 30.05.2022



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁸ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁹, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Inventarizimi i shkollave, vlera 55,850.70€ (zotimi lëshuar dt. 08.02.2021 derisa fatura është pranuar me dt. 23.12.2020); Furnizim me teste serologjike për sars cov 19, vlera 100,029.30€ (zotimi lëshuar dt. 09.02.2021 derisa fatura është pranuar me dt. 23.12.2020); Sigurimi fizik i dy shkollave të mesme, vlera 1,711.20€ (zotimi lëshuar dt. 11.11.2021 derisa faturat janë pranuar me dt. 08 dhe 10.11.2021); Shërbime kontraktuese tjera, vlera 4,134.53€ (zotimi lëshuar dt. 12.08.2021 derisa fatura është pranuar me dt. 02.08.2021); Pagesa e servisimit të automjeteve të komunës, vlera 407€ (zotimi lëshuar dt. 12.11.2021 derisa fatura është pranuar me dt. 08.11.2021).
- ⁵ Furnizim me teste serologjike për sars cov 19, 100 029,30 €; Inventarizimi i shkollave, 55,850,70€; Asfaltimi i rrugëve në fshatin Gradicë dhe Likoshan, 5424.75€; Rehabilitim dhe rikonstruimi i kanalizimeve në glllococ, 38,791€; Rehabilitim dhe rikonstruimi i kanalizimeve në glllococ, 16,848.93€ glllococit.
- ⁶ Furnizim me pajisje të kabinetëve, vlera 1,838€; Furnizim me pajisje tjera, vlera 3,483.50€; Pajisje tjera, vlera 92.50€; Furnizim me pajisje mjekësore, vlera 8,292.07€.
- ⁷ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁸ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁹ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.